



Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,
mbajtur më 4.7.2024, e cila filloj në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Trieri Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Berat Lahu (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Amir Simnica (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK) Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Edmond Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Berna Saraçi (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK) dhe Arbnora Ajeti (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkyetar, Vigan Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donjeta Dragusha, drejtore e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Sibel Halimi, drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Doruntinë Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Bardh Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Donika Çetta, dejtore e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të medieve.

Faqe 1 nga 3

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, i cili tha se për këtë mbledhje është paraparë ky

Rend i ditës:

1. Propozim-vendimi për vënie në diskutim publik të projektdokumentit: Projekt plani i zhvillimit komunal 2024-2032 (PZHK);
2. Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcializimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimi individual), të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona perëndim" dhe ndërrimi i destinimit, të Bll. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHUsë, në Prishtinë.

Pika e parë

Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Projektdokumentit: Projektplan i zhvillimit komunal 2024-2032 (PZHK).

Për këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi hapi diskutimin.

Jeta Rafuna theksoi se ky dokument është i një rëndësie të veçantë, sepse përfshinë sektorët e ndryshimit që ndikojnë drejtpërsëdrejti në jetë e qytetarëve të Prishtinës. Ky dokument përfshin fushat zhvillimore në strukturën e banimit dhe çështjet e mjedisit, zhvillimit ekonomik, të infrastrukturës, të trashëgimisë kulturore, natyrore dhe turistike.

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përfshihen sektorët me rëndësi jetike për të ardhmen e ekonomive familjare, çështjet e punësimit, bujqësia, industria, turizmi dhe zonat ekonomike. Ky plan zhvillimor komunal sot do të vihet në diskutim publik që të merr dritën e gjelbër për të dalur në diskutim publik, ku secili qytetar ka të drejtë që të përfshihet në diskutimet lidhur me këtë dokument, duke u bërë pjesë aktive e hartimit të vizionit për të ardhmen e kryeqytetit tonë, përmes propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve. Po ashtu, miratimi i këtij dokumenti pas fazës së diskutimit publik, do t'i hapë rrugë hartimit të hartave zonale, duke trajtuar kërkesat e qytetarëve, në nivel të parcelave të tyre, prandaj si grup i asamblistëve të LDK-së, së bashku me asamblistët e tjera që kemi thirrur këtë seancë, ju ftojë dhe ju lus të votoni këtë plan zhvillimor që të dalë në diskutim publik.

Gëzim Sveçla tha se ky projektdokument i PZHK-së, i ka 28 të gjatura, komente negative, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, të cilat kanë kërkuar nga ky ekzekutiv që të njëjtat t'i rregullojë dhe t'i përshtasin me ligjet dhe dokumentet në fuqi.

Kyetari Rama dhe ekzekutivi kanë vazhduar me paligjshmëri, ashtu siç kanë filluar nga fillimi i mandatit të tyre, duke injoruar tërësisht opinionet dhe rekomandimet e nivelit qendror. PZHK-ja bëhet në koordinim, në mbështetje dhe duke iu referuar planeve hapësinore në nivel vendi, por ekzekutivi i Prishtinës i injoron këto plane. Plani zhvillimor komunal është dokumenti kryesor për zhvillimin e qytetit për një periudhë 8-vjeçare, kështu që z. Rama i ka pasur tri vite kohë që ta bëjë Planin zhvillimor komunal, nuk e ka bërë, është marrë me çështje të tjera.

Faqe2nga3

Nuk ka mundësi ligjore për të kaluar ky plan, nuk ka institucion që mundet me kaluar një PZHK me 28 vërejtje administrative ligjore dhe substanciale, kështu që ju bëjë thirrje të gjithëve, së pari ekzekutivit, ta tërheqë këtë PZHK, ta bëjë PZHK-në ashtu siç e thotë ligji. **Leutrim Retkoceri** tha se pas analizimit të këtij dokumenti, kemi konstatuar se ky plan ka të meta ligjore dhe procedurale dhe është përgatitur nga një grup njerëzish në krye me Përparim Ramën, që Planin zhvillimor për Kryeqytetin e trajtojnë si plan për biznes dhe grupe të interesit. Plani i propozuar është përpiluar në zyrat me dyer të mbyllura, pa transparencë, ku janë kontrabanduar interesa individuale, biznesore në dëm të interesit publik për kryeqytetin.

Shkeljet e patolerueshme janë se, Plani zhvillimor komunal i propozuar me vizionin thelbësor të Komunës, pa analizë paraprake, bazuar në statistikat e vjetra, kanë ndryshim drastik në vijat e planit ndërtimor dhe vijat ndërtimore në hartat ekzistuese. Hartat ekzistuese nuk janë në përputhje me ligjet si ato vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare të standardeve, që do të thotë se zonat urbane nuk janë të kategorizuara sipas standardeve. Ne si grup i këshilltarëve të PDK-së qëndrojmë kundër formës së këtij plani të propozuar si të paligjshëm, që dëmton interesin e këtij qyteti dhe nuk do të vazhdojmë më tutje të qëndrojmë në një seancë ku propozohen dokumente të paligjshme.

Gëzim Mehmeti tha se tani ne jemi në një situatë me të cilën po ballafaqohemi me një dokument shumë të rëndësishëm, me Plani zhvillimor komunal, i cili determinon shumë çështje. Nuk është sot vendimi përfundimtar, kjo po propozohet që të hidhet në diskutim publik. Ka shumë çështje që duhet me i ndryshuar në aspektin ligjor, tekstual, në aspektin grafik, por këtë duhet ta bëjmë së bashku në interes të qytetarëve të Prishtinës. Nuk kemi zgjidhje tjeter, çdo vonësë ka me na prolonguar dhe ne nuk do të jemi aspak korrekt ndaj qytetarëve të Prishtinës.

Pas diskutimit të z. Mehmeti, kryesuesi tha se nuk kemi kuorum për vazhdimin e mbledhjes dhe e konstatoi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina**

Faqe3nga3

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishtina-komuna.org>

